



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 4

Tiranë – E hënë, 4 shkurt 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 930, datë 4.2.2019	Shpallje për 1 vend vakant për pozicionin drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Publikun..... 3
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 622, datë 30.1.2019	Për shprehje interesi për shërbim konsulence për “Specialist i Menaxhimit Financiar”, Konsulent Individual Lokal - REF. NO. SAMP/CS/IC/03-2019, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale..... 3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 155, datë 30.1.2019	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Bashkisë Përmet..... 4
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 157, datë 30.1.2019	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Bashkisë Tropojë..... 5
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 15, datë 31.1.2019	Për shprehje interesi për shërbim konsulence për “Asistencë Teknike për rishikimin e ligjit për sistemin shëndetësor dhe ligjit për shërbimin spitalor dhe përgatitja e një analize risku dhe impakti për ligjin për shërbimin spitalor” Nr. Ref: HSIP/CS/IC/6-2018, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale..... 6

**NJOFTIM****Nr. 930, datë 4.2.2019**

**SHPALLJE PËR 1 VEND VAKANT PËR
POZICIONIN DREJTOR NË
DREJTORINË E MENAXHIMIT TË
ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE
ME PUBLIKUN**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Publikun në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: II-b.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë të nivelit “master i shkencave” në drejtësi;

b) të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;

c) të kenë të paktën pesë vjet përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letër-njoftim, librezë pune) (originale ose të noterizuar);

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 15 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: “Rruga e Kavajës”, Ish-Lidhja e shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna në të premte, ora 8:30-17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

KËRKESË**Nr. 622, datë 30.1.2019**

**PËR SHPREHJE INTERESI
SHËRBIM KONSULENCE
PËR “SPECIALIST I MENAXHIMIT
FINANCIAR”, KONSULENT
INDIVIDUAL LOKAL - REF. NO.
SAMP/CS/IC/03-2019**

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale - (SAMP)

Hua No.: 8841- AL

Nr. i identifikimit të Projektit: P162079

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (“Shërbim”) së kërkuar është **“Specialist i Menaxhimit Financiar”**.

Termat e Detajuara të Referencës (TOR) për këtë shërbim gjenden në faqen e internetit si vijon: <http://www.shendetesia.gov.al/kerkesa-per-shprehje-interesi/>

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit SAMP fton të gjithë konsulentët legjitimë (“Konsulentë”) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion ku të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimin e kërkuar.

Kriteret e shortlistimit janë:

1. Kualifikimet e përgjithshme	30 pikë
2. Eksperienca të ngjashme	40 pikë
3. Aftësia për të kryer shërbimin	30 pikë
Totali	100 pikë



Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në Seksionin III, paragrafët 3.14, 3.16 dhe 3.17 të “Rregullave të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FPI-së”, të datës korrik 2016 (“Rregullat e Prokurimit”).

Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është përzgjedhje sipas konsulencës individuale (IC), në përputhje me procedurën e përcaktuar në Rregullat e Prokurimit.

Konsulenti do të kontraktohet me kohë të plotë pune për periudhën që fillon nga shkurti 2019 dhe vazhdon deri më 30 qershor 2021.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00-16:30 nga e hëna deri të enjten dhe 08:00-14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me e-mail) deri më **12 shkurt 2019**.

**Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës
Sociale (SAMP)**

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale – Kati I**

**“Rruga e Kavajës”, nr. 53, AL - 1001, Tiranë,
ALBANIA**

**Në vëmendje të: Znj. Suzana Papadhopulli
e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com**

NJOFTIM

Nr. 155, datë 30.1.2019

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
BASHKISË PËRMET**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, në zbatim të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, kapitulli III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Bashkisë Përmët

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	“Stalla e derrave”	Kutal, Përmët	3 673 849	3 510 571	163 278	846	156	26.2.2019	12:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim: Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës

fillestare të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.



3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al.

NJOFTIM

Nr. 157, datë 30.1.2019

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË BASHKISË TROPOJË

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, në zbatim të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, i ndryshuar, kapitulli III, pika 16, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Bashkisë Tropojë.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1.	Ish-Këshilli Popullor	Bajram Curri	9 094 860	8 467 405	627 455	355	263.3	13.2.2019	12:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës



fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimi të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimi të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë www.financa.gov.al.

KËRKESË

Nr. 15, datë 31.1.2019

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (REOI) (CONSULTING SERVICES)

International Technical Assistance-Individual Consultant

January 29, 2019

Albania Health System Improvement Project (HSIP)

Loan No: 8466 AL.

Project ID Number: P144688

Assignment Title: 'Technical Assistance on revision of health law and hospital law and Risk Impact Assessment for hospital law'

Reference No. HSIP/CS/IC/6-2018

The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Health System Improvement Project (HSIP), and intends to apply part of the proceeds for consulting services. The Objective of this assignment is to hire an International individual Consultant to perform the assignment '**Technical Assistance on revision of health law and hospital law and Risk Impact Assessment for hospital law**'. The consultancy will provide legal advice and work closely with the staff of the Ministry of Health and Social Protection to contribute in the compilation of the methodology of drafting the new legal framework that fills in the legal gaps and adequate model of provider autonomy from both an administrative and a legal perspective, covering governing and financial aspect as well as transformation of hospital health services and the relevant legal act and more importantly conduct the Risk Assessment Impact.

Consultant should fulfill the following requirements:

- University degree in law.

- At least 10 years of relevant professional experience in the field of health financing or health insurance.

Experience with legislation/regulatory and institutional/financial issues in health care services and hospital autonomy regulation.

Previous experience on conducting similar assignment associated with two letters of recommendation issued from previous clients;



Experience in the region is desirable;

The working language is Albanian and English. Albanian translation will be confirmed by the legal department of MoHSP.

The Ministry of Health and Social Protection, through Project Coordination Unit (PCU) now invites eligible individual international consultants

(“Consultants”) to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services (as described above). The evaluation criteria are:

No.	Evaluation Criterion	Points
1.	General Qualification	30
2.	Relevant Specific Experience in the field of the assignment	40
3.	Capability to carry out the assignment	30
TOTAL		100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank’s [Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers](#) (January 2011, revised July 2014), setting forth the World Bank’s policy on conflict of interest.

The consultant should be an **Individual International Consultant**. The selection method to be applied is **Individual Consultant Consultants** (IC), in accordance with the procedures set out the World Bank’s Guidelines Selection and Employment of Consultants Under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers” (January 2011, revised July 2014).

The assignment should be performed within 20 weeks period. The consultant will spend for this assignment 55 man days where 40 man days will be home based and 15 of them on site (Albania). The contract will be Lump Sum Payment. During the

course of the contract implementation, the consultant is required to conduct 3 site missions. Each of them will last at least 5 days.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday In the address below).

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by e-mail) by **18th of February 2019**.

Ministry of Health and Social Protection
Adress: Rruga e Kavajës No. 53, Tirana-Albania

Project Coordination Unit (PCU)
Health System Improvement Project (HSIP)

Att: Blerina Dudushi

e-mail: hsip.dudushi@gmail.com

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019